

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2021

Në Kuvendin e Shqipërisë është paraqitur raporti “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021” bazuar në përcaktimet e neneve 104 dhe 105, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në raportin “Mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021” janë paraqitur treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës dhe veprimtaria e realizuar në zbatim të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021:

Vlerëson rolin e Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë.

Vlerëson ngarkesën që Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja kanë mbajtur gjatë vitit 2021, rezultatet pozitive të evidentuara në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe fillimin e mirë për hetimin e disa çështjeve të cilat lidhen me korrupsionin.

Vlerëson rezultatet pozitive në luftën kundër krimit organizuar dhe rritjen e besimit të homologëve ndërkombëtarë të SPAK-u.

Vlerëson rritjen e vlerës së aseteve të konfiskuara që gjatë vitit 2021 arriti 70 milionë euro, si dhe rritjen e numrit të çështjeve që janë përfunduar me vendime dënimi në fushën e pastrimit të parave dhe rritjen e konfiskimeve të aseteve kriminale në procesin penal.

Konsideron shumë të rëndësishëm plotësimin e të gjithë strukturës së SPAK-ut me prokurorë sipas numrit të miratuar me vendimin e Kuvendit, ashtu si edhe plotësimin e strukturës së BKH-së me numrin e hetuesve të përcaktuar dhe strukturën mbështetëse të Policisë Gjyqësore sipas detyrimit të përcaktuar në ligjin përkatës.

Rithekson nevojën e krijimit të një sistemi “historik” për menaxhimin e çështjeve, e cila do t’u japë më shumë mundësi institucioneve për të pasur transparencë dhe pavarësi në trajtimin e çështjeve.

Shpreh shqetësimin lidhur me gjetjet e prezantuara në një sërë raportesh të organizmave ndërkombëtarë, por edhe atyre vendorë, veçanërisht nga progresraporti i KE-së për vitin 2021 në të cilat theksohet se, pavarësisht se janë bërë hapa pozitivë, mbetet ende shumë për të bërë sidomos nga strukturat e specializuara të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit në nivelet e zyrtarëve të lartë.

Vlerëson se Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë pasur mbështetje aktive me burime buxhetore e njerëzore, në trajtimin me paga dhe përfitime të tjera financiare shtesë dhe me instrumente ligjore shtesë në funksion të rritjes së efikasitetit të tyre dhe çmon se kjo mbështetje ka rritur pritshmërinë e taksapaguesve shqiptarë për një ritëm më të shpejtë në rezultate më domethënëse në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta në veçanti, pavarësisht kohës dhe personave të përfshira në to, si kusht thelbësor për të forcuar më tej besimin e publikut te drejtësia.

Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2021 konstaton se:

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka miratuar 691 urdhra në funksion të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Gjatë vitit 2021 është realizuar përzgjedhja e 32 kandidatëve hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit.

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2021 ka përfunduar raportet e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për 37 subjekte dhe vazhdojnë verifikimet edhe për 133 subjekte.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka ndërtuar një infrastrukturë moderne sipas parametrave të standardizuar teknikë, si dhe sisteme kontrolli dhe sigurie për të garantuar sigurinë e institucionit. Gjithashtu, është realizuar aksesimi dhe përdorimi për qëllime hetimi i 9 databazave, ndërsa për 8 databaza të tjera puna është në proces.

Është realizuar regjistri elektronik dhe manual për çdo të dënuar duke shënuar të dhënat kryesore dhe Regjistri i Konfiskimeve, sipas vendimeve të gjykatës dhe emrave të të dënuarve, ku përcaktohet informacioni i konfiskimit të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe vlerat monetare përkatëse.

Është realizuar regjistri elektronik dhe manual për personat e vendosur në regjim të posaçëm.

Është hetuar një numër i konsiderueshëm i procedimeve penale (gjithsej 715), ku janë përfunduar hetimet për 226 procedime penale me 332 persona nën hetim (për 48 procedime penale janë paraqitur kërkesa për gjykim).

Gjatë vitit 2021 janë transferuar për efekt të juridiksionit 35 procedime penale me 21 të pandehur nën hetim në fushën e antikorrupsionit.

Nga 519 persona nën hetim, janë përfunduar hetimet për 332 persona nën hetim/të pandehur, që i korrespondon rreth 64% e numrit total të personave në hetim.

Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 128 çështjeve penale themeli, me 418 persona të akuzuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në gjykimin e 4 çështjeve penale në Gjykatën e Lartë, si dhe kanë marrë pjesë në 2 raste në Gjykatën Kushtetuese.

Janë ekzekutuar 77 vendime gjyqësore të formës së prerë, nga këto 36 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe janë dënuar 171 të pandehur.

Është konfiskuar pasuria në proces penal për 41 vendime penale dhe janë nxjerrë urdhrat e prokurorit për ekzekutimin e vendimeve penale për 171 të dënuar, duke krijuar praktikë përkatëse në bashkëpunim me prokurorët e çështjeve.

Është përdorur metoda e përgjimit për 129 procedime penale me një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e mëparshëm.

Janë ekzekutuar në interes të procedimeve penale nën hetim 411 autorizime të Prokurorit për lejim përgjimi, 1204 vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, 224 vendime lejim përgjimi, 400 vendime vleftësimi dhe 580 vendime zgjatjeje për afatin e lejimit të përgjimit.

Për veprat penale nën hetim, janë interceptuar rreth 1500 subjekte, 1957 pajisje fundore, ku është rezultuar në ndalimin e rreth 179 personave të dyshuar për kryerje të veprave penale.

Janë paraqitur pranë sektorit të ekspertizës 118 vendime ekspertimi.

Janë trajtuar 91 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja dhe janë ekzekutuar 41 letërporosi dhe ndodhen në proces ekzekutimi 50 letërporosi të drejtuar nga autoritetet gjyqësore të huaja për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë.

Janë ngritur 10 skuadra të përbashkëta hetimore me strukturat homologe të Republikës së Italisë.

Janë kryer bashkëpunime me projekte të asistencës së huaj në funksion të punës së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Shorti i çështjeve në Prokurorinë e Posaçme hidhet manualisht sipas përcaktimeve të nenit 15, pika 2, germa “b” të ligjit nr. 95/2016; nuk është plotësuar ende numri i hetuesve të parashikuar në strukturën e BKH-së; nuk ka përfunduar procesi i ngritjes së shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë BKH-së; është ngritur ekspertiza digjitale, por duhen plotësuar me ekspertë kontabël sektorët e ekspertizës.

Vlerësohet se nuk është ngritur ende sistemi i menaxhimit të çështjeve penale ose sistemi i menaxhimit unik i çështjeve, pavarësisht se ka qenë rekomandim i rezolutës së Kuvendit dhe i progresraportit të Komisionit Europian në mënyrë të përsëritur për disa vite radhazi.

Janë mbartur nga viti i kaluar 348 çështje, pothuajse 50% e procedimeve penale, duke sjellë ngarkesë për Prokurorinë e Posaçme.

Nga të dhënat e raportimit vjetor rezulton se për vitin 2021 vetëm për 48 procedime penale është paraqitur kërkesë për gjykim. Ndërkohë në vitin 2020 është paraqitur kërkesë për gjykim për 70 procedime penale, gati 22 çështje më pak, çka flet për një ritëm më të ulët të çështjeve të mbyllura për një vit.

Bazuar në nenin 28 të ligjit organik parashikohet se Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kane akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e duhur për hetimin e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Sipas raportimit, rezulton se është realizuar akses në një pjesë të databazave shtetërore, konkretisht 9 sisteme, si: Sistemi i Gjendjes Civile, ASHK-ja, Drejtoria e Burgjeve, Regjistri i Llogarive Bankare, Sistemi elektronik i DPT-së, SEMD-ja, DPSHTRR-ja, TIMS-i. Një pjesë tjetër janë në proces, si: Regjistri Noterial Shqiptar, Regjistri i Pronarëve Përfitues, sistemet e Policisë së Shtetit ADAM, DEEPSE, E-Gjoha, Raporte Statistika, Memex, sistemi i APP-së.

SPAK ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të strukturës së posaçme dhe funksionimit efektiv të mbikëqyrjes në zbatim të detyrimeve të nenit 42 të ligjit nr. 95/2016.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

1. Të konsiderojë thelbësore në veprimtarinë e saj pavarësinë institucionale dhe funksionale të strukturës, veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në hetim dhe vendimmarrje, si dhe përgjegjshmërinë e llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duke krijuar një sistem të qartë treguesish për punën e çdo prokurori e hetuesi si bazë edhe për vlerësimin e promovimin e tyre individual mbështetur në rezultatet konkrete të punës.

2. Të vlerësojë si prioritet forcimin e cilësisë së hetimeve përmes përdorimit me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, rritjes së numrit të çështjeve të hetimeve kryesisht dhe hetimeve proaktive, përdorimit më efikas dhe në kufijtë e ligjit të udhëzimeve të përgjithshme nga ana e drejtuesve të Prokurorisë së Posaçme, rritjen e shpejtësisë në hetime duke rritur numrin e çështjeve që përmbillen në një vit dhe dërguar për gjykim, si dhe marrjen e masave për aksesin e drejtpërdrejtë në të gjitha databazat shtetërore nga struktura e posaçme për të hetuar çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

3. Të forcojë mekanizmat e kërkesës dhe llogaridhënies së brendshme administrative të prokurorëve dhe hetuesve të SPAK-ut për eficiencën dhe efikasitetin e punës, pa cenuar pavarësinë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre ligjor duke rivlerësuar metodologjinë e hedhjes së shortit, plotësimin e detyrimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve që janë objekt shqyrtimi i SPAK-ut në përmbushje të rekomandimeve të progresraporteve të KE-së, rezolutave të Kuvendit, si dhe zbatimit të detyrimeve ligjore.

4. Të nxisë prokurorët dhe hetuesit e SPAK-ut, sidomos drejtuesit e tyre për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri dhe hetime kryesisht dhe proaktive në çështjet e korrupsionit në nivelin e zyrtarëve të lartë, me prioritet çështjet me interes të veçantë publik, pavarësisht kohës së kryerjes së tyre dhe personave të përfshirë në to, për të cilat mbetet ende e fortë pritshmëria dhe shpresa e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për respektimin e barazisë para ligjit nga institucionet e reja të drejtësisë, dhe veçanërisht nga SPAK-u.

5. Të vijojë forcimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin dhe të

zbatohen standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtës për proces të rregullt, parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

6. T'i kushtojë një vëmendje të shtuar zbatimit të kërkesave të ligjit në çështjet penale, të cilat transferohen nga Prokuroria e Posaçme në prokuroritë e rretheve gjyqësore për efekt të juridiksionit.

7. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe funksionalitetin e saj, si dhe të përmbyllë të gjitha vakancat në strukturën e BKH-së për sa i përket rekrutimit të 60 hetuesve dhe të krijohet struktura e masave për ushtrimin e kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve për punën e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

8. Të zbatojë në kohë detyrimet që rrjedhin nga ligji për funksionimin efikas të sektorëve të dokumentacionit, studimeve, sidomos atyre të ekspertizës e hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë BKH-së, si dhe, për sa çmohet e nevojshme, ngritjen e zyrave mbështetëse jashtë Tiranës.

9. Të vazhdojë puna për mirëfunksionimin e SPAK-ut për zbatimin e përcaktimeve të shkronjave “dh”, “ë” dhe “f”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe për bashkëpunimin me ekspertët ndërkombëtarë të drejtësisë penale për ngritjen dhe zhvillimin e BKH-së.

10. Të vijojë koordinimin e veprimtarisë ndërinstitucionale dhe efektivitetin për hetimet në ndjekjen penale të financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF), si dhe të raportohet në Kuvendin e Shqipërisë çdo 6 muaj për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

11. Të miratojë një plan veprimi të mirëkoordinuar për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese në bashkëpunim me misionet dhe projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

12. Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve, hetuesve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave me agjencitë e zbatimit të ligjit.

13. Të realizojë marrëveshjet teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, krimin e organizuar, si dhe luftën kundër terrorizmit.

14. Të publikojë udhëzimet e përgjithshme në faqen zyrtare të institucionit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 5, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

15. Të marrë masa për rritjen e transparencës publike përmes një strategjie komunikimi aktive me publikun, informimit të qytetarëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile.

16. Të raportojë në Kuvend në përputhje me përcaktimet e vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe, për aq sa është e mundur, për evidentimin e problematikave dhe rekomandimet përkatëse për parandalimin e kriminalitetit dhe korrupsionit në shoqërinë shqiptare, në funksion të nevojës për të ndërtuar politika më të mira shtetërore në interes të së ardhmes së vendit.

17. Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit me Bashkimin Evropian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021, përfshi edhe marrjen e masave për krijimin e “*track rekordi*” solid për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian.

Miraturar më datë 14.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla